



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:207018
Datë: 22.01.2025
Numri i dokumentit: 06740522

C.nr.667/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Feim Bytyqi, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M.S nga Rahoveci, të cilën me autorizim e përfaqëson Sh.Z avokat nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me objekt kontesti kompensimi për orët e mësimit gjatë fundjavave, vlera e kontestit 500.00 euro, jashtë seancës, me datë 22.01.2025, bie këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditëses M.S nga Rahoveci, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura Komuna e Rahovecit - DKA, që në emër të kompensimit për ditët e punës gjatë fundjavës, për periudhën kohore nga data 09.10.2021 deri me datën 14.01.2023, të ia paguaj pagën neto në shumën prej 469.44 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 52.58 euro, si dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 27.76 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.

II. Secila palë i bart shpenzimet e saj procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja M.S nga Rahoveci, nëpërmjet të autorizuarit të saj avokat Sh.Z nga Rahoveci, me datë 18.07.2024 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura, që në emër të kompensimit për ditët e punës gjatë fundjavës, për periudhën kohore nga data 09.10.2021 deri me datën 14.01.2023, të ia paguaj pagën neto në shumën 469.44 euro, në emër të kontributit pensional shumën prej 52.58 euro, si dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 27.76 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%.

Ndër të tjera në padi ka theksuar se sipas vendimit të MASHT nr. 01/B, nr.1860 të datës 28.09.2021 të punësuarit në arsim janë detyruar nga e paditura për kompensimin e ditëve të mësimit të humbura për shkak t gjendjes së pandemisë COVID-19, përkatësisht janë detyruar që dhjetë ditë të mësimit të zëvendësohen - mbahen ditëve të shtune. Më tej ka shtuar se paditësi nuk është paguar për ditët për të cilat ka punuar gjatë fundjavës dhe pushimit, për të cilët konsiderohet se ka punuar jashtë orarit. Paditëses në bazë të nenit 56, par.2, nënpar.2.5 Ligji nr.03/L-212 i Punës i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, përkatësisht 50% për orë për punë gjatë fundjavës. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata me aktvendimin C.nr.667/2024, të datës 01.10.2024, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, nën kërcënimin e pasojave procedurale, të cilin vendim e paditura, e ka pranuar me datë 10.10.2024.

E paditura me datë 14.10.2024, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses. Në të cilën ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë e vetme në këtë çështje kontestimore. Më tej ka shtuar se në kuptim të nenit 46 par.2 të Kontratës Kolektive është paraparë që MASHT dhe SBASHKU të angazhohen bashkërisht në Ministrinë e Financave për sigurimin dhe ndarjen e mjeteve financiare për Komunat e Republikës së Kosovës, me qëllim të realizimit të buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 par. 5,7 dhe 9, brenda mundësive institucionale, ligjore dhe administrative. Andaj Komuna e Rahovecit nuk ka përgjegjësi direkte për zbatimin e dispozitave që kanë implikime financiare të Kontratës Kolektive për të punësuarit në sistemin arsimor në Kosovë, këtë obligim duhet ta merr përsipër Ministria e Arsimit, së bashku me dikasteret tjerë përkatës, respektivisht palët nënshkruese të Kontratës Kolektive. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 399 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”* dhe ka arritur në përfundimin se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e vendimit meritore jashtë seance me të cilin duhet të refuzohet kërkesëpadia e paditëses si e pathemeltë.

Nga përmbajtja e kontratës së paditëses, përkatësisht nenit IV të saj, thuhet se *“I punësuari është i obliguar ta realizojë planë programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës”*.

MASHT, duke vepruar konform Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ka nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar plan programin mësimor, konkretisht me datë 12.08.2022 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 05/2022, për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023.

Në nenin 1 të këtij udhëzimi përcaktohet se *“Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave filllore, klasave para fillorë, shkollave të mesme të ulëta, shkollave mesme të larta, institucioneve parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe këshillim”*.

Në nenin 8 të këtij udhëzimi përcaktohet se *“Ditët dhe javët e obliguara të mësimi dhe të punës”*;

1. Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantët, janë të obliguar 160 ditë mësimi, tridhjetëdy (32) javë,
2. Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi. 35 javë.
3. Për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët para fillor, janë të obliguara 185 ditë mësimi, 37 javë.
4. Institucionet parashkollore, duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 7 të këtij udhëzimi.

5. *Pushimet verore për institucionet parashkollore rregullohen nga institucionet parashkollore në bashkëpunim me DKA-në, gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 15 gusht, ku brenda kësaj periudhe kohore planifikojnë pushimin vjetor në bazë të ligjit të punës.*

6. *Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është gjatë ditëve të punës, u lejohet të planifikojnë zëvendësimin e mësimin, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim.*

7. *Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASHTI merr vendim të veçantë”, pra nga përkufizimi i kësaj dispozite, del se Mashti me akt nënligjor përcakton ditët dhe javët e obliguara të mësimin dhe të punës dhe se ndryshimi i këtij Udhëzimi, sipas nenit 8 par. 7 të tij, bëhet me vendim”.*

Para fillimit të vitit shkollor 2022/2023, SBASHKU, me datë 25.08.2022 kishte vendos që të futet në grevë si rrjedhojë e grevës, mësimdhënësit nuk i kanë përmbushur detyrimet që dalin nga kontratat e tyre të punës, përkatësisht nuk kanë implementuar Udhëzimin Administrativ nr. 05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023.

Pasi që me datë 03.10.2022 SBASHKU e kishte ndërprerë grevën, MASHT konform nenit 8 par. 7 të UA.nr.05/2022, ka nxjerr vendimin numër 0113/453 të datës 04.10.2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2022-2023, me të cilin vendim ishte përcaktuar që të zëvendësohen ditët e humbura gjatë grevës, ashtu që ishte vendosur që kalendarin mësimor i vitit shkollor 2022/2023 të realizohet në edhe në tetë (8) ditë të fundjavës, konkretisht ditën e shtunë, të datave 15.10.2022, 22.10.2022, 29.10.2022, 12.11.2022, 26.11.2022, 10.12.2022, 24.12.2022, 14.01.2023. Ndërkaq, po me këtë vendim (pika 9) ishte përcaktuar që mësimdhënësit të cilët nuk kanë marrë pjesë në grevë të zbatojnë kalendarin mësimor të përcaktuar me UA.nr.05/2022 (Pra të njëjtit nuk kanë punuar gjatë ditëve të shtunë).

Po ashtu duhet theksuar faktin se pavarësisht se në Ligjin për Grevat, në nenin 18 par. 1 të tij thuhet se “Gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet, që rrjedhin nga Kontrata e Punës”, ndërsa me plotësim ndryshimin e Ligjit për Grevat, neni 7 par. 1, përcakton se “1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas togfjalëshit “Kontrata e Punës” shtohet fjalia “duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punua”, pra përcaktohet që pezullohen të drejtat nga kontrata e punës, duke përfshirë edhe pagesën e mësimdhënësve si grevist, është fakt i njohur botërisht që të gjithë mësimdhënësit, duke u përfshirë edhe paditësin, gjatë periudhës së grevës ka realizuar pagën e rregullt mujore sikurse të kishte punuar.

Nga të lartcekurat, gjykata vërteton se pretendimi i paditëses për kompensimin pagës shtesë për shkak të punës më të gjatë se sa orari i plot i punës, është në tërësi i pabazuar, për arsye se orët e punës për paditësin si në kontratën e tij të punës, janë përcaktuara në Udhëzimi Administrativ nr. 05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023 dhe në vendimin me numër 0113/453 të datës 04.10.2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2022-2023, ku për paditësen si mësimdhënëse e klasave 1-8-të, kanë qenë të përcaktuara 185 ditë mësimi, (37) javë, ndërsa në kontratën e tij të punës janë përcaktuar 20 orë mësimi në javë, përkatësisht 40 orë pune në javë, andaj paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se i njëjti ka punuar më gjatë se sa orari i punës së përcaktuar në UA.nr.05/2022 dhe në kontratën e tij të punës, e si rrjedhojë nuk mund të zbatohet neni 56 i Ligjit të Punës për kompensimin e punës jashtë orarit, sepse paditësi me punën e realizuara gjatë të shtunave të periudhës tetor-dhjetor 2022 dhe janar 2023, nuk ka punuar orë shtesë, por i njëjti ka zbatuar vetëm detyrimin e tij për të përmbushur orët e tij mësimore, të përcaktuara nga kontrata e punës, e në të cilën kontratë nuk janë të përcaktuara ditët e javës brenda të cilave duhet të përmbushën orët mësimore, por vetëm fondi i orëve mësimore, andaj me vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vitit kalendarik të vitit

shkollor 2022-2023, nuk nënkupton faktin se paditësi në mënyrë burimore ka punuar orë më tepër se sa ato të përcaktuar në UA.nr.05/2022, si dhe fakti se ai ka punuar ditëve të shtune, në asnjë formë nuk ka cenuar të drejtat e tij që rrjedhin nga Ligji për Grevat.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.667/2024, datë 22.01.2025

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Feim Bytyqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.